

## Mik i shqiptarëve në ditë të veshitura

*Dr. Robert Elsie është njëri prej albanologëve (kanadez i cili jeton në Gjermani), që në masë të madhe përmes studimeve, artikujve, recensioneve, përkthimeve, kritikave etj, ka afirmuar gjuhën, letërsinë, kulturën dhe vetë kombin shqiptar. Elsie ka mbaruar filologjinë klasike (i njuh të gjitha gjuhët indoevropiane). Për gjuhët krahasimtare studioi në Francë, Irlandë, Gjermani etj. Ka botuar mjaft, në mes të cilëve edhe Leksikonin e letërsisë shqipe në Nju Jork, Antologjinë e poezisë shqipe në Gjermani, Migjenin në anglisht dhe gjermanisht. Në SHBA së shpejti i del libri “Historia e letërsisë shqiptare.” Dr. Elsie është anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së Shoqatës bamirëse “Evropianët për Shqipërinë”. Dalja para një muaji në gjuhën angleze e Antologjisë së poezisë moderne shqiptare, “Një Shqiponjë e arratisur fluturon” (An Elusive Eagle Soars) në Londër-Boston, në botim të UNESKO-s (Forest Books) në zgjedhje dhe përkthim të tij dhe vizita e paradokohshme në Shqipëri e në disa qytete shqiptare në Maqedoni, qenë shkas për këtë bisedë, që e zhvilluam në Tetovë.*

[ShE]: Zoti Elsie, këto ditë në gjuhën angleze në botimët e UNESKO-s ju doli libri Antologjia e poezisë moderne shqiptare, “Një Shqiponjë e arratisur fluturon”. Çka përmban ky libër dhe cili është qëllimi i këtij botimi?

[RE]: Ky libër është edhe një përpjekje nga ana ime për të prezentuar letërsinë shqiptare në botën e jashtme. Është, siç e thatë, një antologji e poezisë moderne shqiptare, që përfshin 24 autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Italia dhe diaspora. Unë u përpoqa në këtë libër të prezantoj poezinë shqipe, sepse është një poezi të themi fare e panjohur për lexuesin perëndimor apo më mirë të themi për lexuesin anglez, amerikan. Shpresoj që ky libër do të ndihmojë pak për afirmimin e letërsisë dhe kulturës shqiptare në botën e jashtme. Libri fillon me dy poetë më të mirë shqiptarë: me Lasgushin dhe Migjenin. Për mua këta dy poetë janë edhe themelues të poezisë moderne shqiptare. Pastaj vazhdon me poetët e tjerë si: E. Mekuli, M. Camaj, F. Arapi, D. Agolli, V. Ujko, D. Mehmeti, Dh. Qiriazhi, F. Gunga, I. Kadare, A. Shkreli, Rr. Dedaj, A. Podrimja, Xh. Spahiu, A. Vinca, E. Basha, N. Lako, B. Londo, M. Zeqo, S. Hamiti, R. Marku, V. Zhiti.

[ShE]: Vërehet një përfshirje e gjërë e krijuesve shqiptarë në këtë antologji. Çfarë kriteri ndoqët gjatë përpilimit të saj?

[RE]: Unë doja të hartoja një antologji që përpiket të përfaqësojë poezinë shqiptare në përgjithësi, megjithëse jam në dijeni se asnjë antologji, asnjë libër nuk mund të përfshijë gjithë poezinë shqiptare. Megjithatë, unë kam mbledhur materialin e disa poetëve më të njohur (për shumicën e rasteve, më duket), për të përfaqësuar poezinë shqiptare. Një kufizim që bëra, dmth. një kufizim që doli nga puna ishte fakti se nuk pata mundësi të përkthej të gjithë poetët, dmth. janë shumë poetë që nuk përkthehen, janë shumë poezi që nuk mund të përkthehen.

[ShE]: Me sa kuptuam kjo antologji është e para e këtij lloji në gjuhën angleze. Çfarë rëndësi ka kjo?

[RE]: Po, kjo është e saktë. Është antologjia e parë shqiptare në gjuhën angleze. Ekzistojnë disa antologji në gjermanisht, frëngjisht, më duket edhe italisht, por anglisht mungonte. Kjo ishte arsyeja ime të filloj këtë punë. Si e dini, anglishtja është gjuhë ndërkombëtare, që flitet jo vetëm në Angli, Amerikë, Australi, por kudo në botë. Ky botim doli me ndihmën e UNESCO-s në Paris, ku ka një sërë librash të popujve të botës në përkthim anglisht dhe frëngjisht. Dhe ky libër në mesin e atyre përfaqëson poezinë moderne shqiptare.

[ShE]: Çfarë janë reagimet me rastin e botimit, vlerësimet e kritikës?

[RE]: Po t'ju them të drejtën nuk di, sepse libri sapo doli nga shtypi para disa javëve dhe nuk kam dëgjuar asnjë vlerësim, asnjë koment deri më tani.

[ShE]: Ju, z. Elsie, jeni edhe autor i mjaft artikujve dhe punimeve shkencore, të cilat i keni botuar në gjuhë të ndryshme. A mund të na thoni çka shtroni aty?

[RE]: Po shikoni, kultura shqiptare është ende mjaft e panjohur për të huajt. Është një kulturë e pasur dhe duhet të njihet më shumë në botën e jashtme. Unë kam botuar nuk di sa artikuj shkencorë lidhur me kulturën shqiptare veçmas për letërsinë shqiptare, për historinë e letërsisë shqiptare që janë botuar nëpër revista të ndryshme botërore. Gjithashtu unë jam duke hartuar një histori të letërsisë shqiptare, që do të botohet vitin e ardhshëm në SHBA.

[ShE]: Çka do të përmbajë kjo Histori e letërsisë?

[RE]: Libri i Historisë së letërsisë shqiptare do të përfshijë të gjitha periudhat e letërsisë shqipe dmth. që nga dokumentet e para e deri më sot. Të gjitha letërsitë, pa ndarje kufijsh si atë të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë etj, pa përjashtime dhe natyrisht pa paragjykime politike siç është botuar Historia e letërsisë shqipë në Tiranë (1983).

[ShE]: Më duket se edhe këtu si në Antologjinë e poezisë do të ndiqni kriterin e mosndarjes së letërsisë në kufij politik apo jo, z. Elsie?

[RE]: Në historinë e letërsisë shqiptare është një çik më ndryshe. Këtu varet nga rrymat e caktuara, nga periudhat e caktuara. Në Antologjinë e poezisë unë kam radhitur autorët sipas vitit të lindjes, kurse në Historinë e letërsisë shqiptare kam ndarë pjesen e letërsisë së sotme në një kapitull historinë e letërsisë në Shqipëri, një kapitull historinë e letërsisë së shqiptarëve të ish Jugosllavisë dhe një kapitull letërsinë arbëreshe. Kështu veprova për arsye se vetvetiu u krijua kjo situatë, duke pasur parasysh ndarjen edhe të vetë kombit shqiptar.

[ShE]: Ju, Z. Elsie, sa po përfunduat vizitën zyrtare në Shqipëri dhe tani po vizitoni edhe disa qytete shqiptare në Maqedoni.

[RE]: Unë isha në Shqipëri si anëtar i një delegacionit qeveritar gjerman për një vizitë njëjavore dhe doja pas vizitës zyrtare të vij privatisht këtu të vizitoj disa qytete shqiptare në Maqedoni. Këtu kam qenë vetëm një herë në Gostivar para 5 vjetësh. Dhe doja të vij të shoh se si është gjendja e shqiptarëve këtu.

[ShE]: Çfarë janë mbresat e para nga kjo vizitë?

[RE]: Pas një vizite në Shqipëri vura re mirëqenien ekonomike të shqiptarëve të Maqedonisë. Kjo është diçka relative. Po të kisha ardhur nga Gjermania natyrisht ndoshta do të kisha parë një varfëri. Jeta në pikëpamje ekonomike në Maqedoni është e mjaftueshme, është e mirë, por nga pikëpamja politike është ndryshe. Jam në dijeni se ka probleme të shumta. Nuk di t'iu bëj vlerësime problemeve politike, veç shpresoj që gjendja të jetë e qetë dhe që popujt këtu në Maqedoni të jetojnë në paqe me njëri tjetrin.

[ShE]: Në Gostivar vizituar Forumin për të drejtat dhe liritë e njeriut. Cili ishte interesimi Juaj?

[RE]: Njëri qëllim i vizitës sime këtu në Maqedoni është për të mësuar diçka më shumë për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Si një mik i popullit shqiptar, po të mund të cilësohem kështu, jam shumë i shqetësuar mbi diskriminimin e hapur kundër shqiptarëve në Maqedoni dhe desha të mbledh disa të dhëna të sakta, mundësisht të sakta për një botim në Gjermani dhe kështu pata rastin të bisedoj me përfaqësuesit e këtij Forumi.

[ShE]: Mendoni se keni arritur të tuboni material që të dëshmoni shkeljen e të drejtave dhe lirive të shqiptarëve në Maqedoni?

[RE]: Material për shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Maqedoni ka sa të dush, dmth. nuk të mungojnë. Është vetëm një çështje, përpilimi dhe sistematizimi i materialit. Nuk ka asnjë dyshim të shkeljes në mënyrë katastrofale të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve.

[ShE]: Jeni edhe anëtar i kryesisë së Shoqatës bamirëse “Evropianët për Shqipëri” me seli afër Këlnit?

[RE]: Po, kjo Shoqatë u themelua para një viti e gjysmë, duke marrë parasysh situatën e rëndë në Shqipëri dhe peshën e fjalës humanitare në vepër. Qëllimi ynë ishte të krijojmë fondin dhe të mbledhim artikuj në këtë kohë të vështirë për kombin dhe shtetin shqiptar. Ne kemi arritur të dërgojmë disa transporte me ndihma ushqimore, veshmbathje, ilaçe, pajisje mjekësore, dhe vazhdojmë edhe mëtej të dërgojmë. Shoqata ka pasur një sukses të mjaftueshëm në këtë vit të vështirë. Shpresoj në të, megjithëse nevojat janë dhe vazhdojnë të jenë të mëdha në Shqipëri.

[ShE]: Dhe në fund edhe një pyetje të zakonshme që ndoshta do të duhej ta kisha bërë në fillim. Krahas gjuhës gjermane, franceze, italiane etj, ju flisni edhe mjaft gjuhë të popujve të vegjël. Shqipen e flisni shumë bukur. Si u lind ideja për mësimin e kësaj gjuhe, si e mësuat?

[RE]: Kjo është një pyetje që bëhet shpesh. Nuk është për t'u çuditur pse njerëzit e mësojnë gjuhën shqipe, por çuditërisht që nuk ka më shumë të këtillë të mësojnë gjuhën shqipe. Shqipja është një gjuhë indoevropiane me mjaft interes. Mësimin e saj e fillova vetë në Gjermani, autodidakt. Isha disa herë në Shqipëri në kohën e diktaturës me grupe të ndryshme turistike. Por, në atë kohë ishte vështirë për mua, sepse askush nuk guxonte të fliste me mua. Pastaj erdha në Kosovë në Seminarin e Gjuhës Shqipe, ku mu dha rasti për të biseduar më tepër me njerëz. Dhe viteve të fundit kam mësuar pak më shumë, duke pasur kontakte me refugjatë nga Shqipëria të ardhur në Gjermani.

E intervistoi Shaip Emërllahu.

[botuar në / published in: gazeta *Flaka e Vëllazërimit*, Skopje, 14 maj/May 1993.]